

01-1941 dt. 11-06-2010  
PRISHTINË - PRIŠTINA



NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE „IBER-LEPENC” SH.A.

HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE „IBER-LEPENC” J.S.C.

VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE „IBER-LEPENC” D.D.

Sheshi "Bil Klinton" Nr.13 Prishtinë, Kosovë/Bulevar "Bil Klinton" Br.13 Priština,  
Kosovo

Tel: 038/226-070, 225-006, Fax: 038/226-159; Email: iber.lepenci@hotmail.com

## RREGULLORE PËR MBROJTJEN N GA ZJARRI

PRISHTINË, PRILL 2010

# RREGULLORE PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI

## I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

### Neni 1

- (1) Me qëllim të mbrojtjes të njerëzve dhe të pasurisë nga zjarri dhe me qëllim të zbatimit të dispozitave që dalin nga Ligji i Mbrojtjes nga Zjarri dhe rregullave tjera në ndërmarrjen „Iber-Lepenc”, ndërmerren masa dhe veprime për largimin e shkaqeve të zjarrit dhe për ofrimin e ndihmës me rastin e largimit të pasojave të shkaktuara nga zjarri.
- (2) Mbrojtjen nga zjarri, e organizon dhe e siguron zbatimin nga Kryeshefi Ekzekutiv.

### Neni 2

- (1) Mbrojtja nga zjarri (MZ) përfshinë tërësinë e masave dhe veprimeve juridike, teknike, arsimore dhe te natyrës propaganduese.
- (2) Mbrojtja nga zjarri, organizohet dhe zbatohet e kontrolluar në të gjitha meset, objektet dhe vendet të ndërmarrjes ku ekziston rreziku dhe mundësia për shfaqjen e tij.
- (3) Këto dispozita dhe masa kanë për qëllim zvogëlimin, largimin dhe marrjen e masave preventive për zvogëlimin ose eliminimin e rrezikut nga kjo lëmi.
- (4) Punët për mbrojtjen nga zjarri janë në interes të përbashkët të ndërmarrjes si tërësi. Ato janë pjesë përbërëse të çdo aktiviteti punues që organizohet dhe zbatohet njësoj në të gjitha vendet e punës, në lokale, depo dhe objekte tjera.
- (5) Dëmtimi, shkatërrimi i pasurisë së ndërmarrjes si dhe dëmtimi shëndetit të punëtorëve konsiderohen si dëm apo fatkeqësi për ndërmarrjen.
- (6) Duke i mbrojtur punëtorët dhe pasurinë e saj, ndërmarrja është e obliguar që, në mënyrë të njëjtë dhe me syqeltësi të njëjtë, të mbrojë edhe objektet fqinje dhe njerëzit që gjenden në rrezik.

*B.*

### Neni 3

- (1) Punëtorët në objekte janë të obliguar të veprojnë dhe të zbatojnë masat e mbrojtjes kundër zjarrit, në harmoni me ligjet dhe rregullat në fuqi.
- (2) Punëtorët e N.H "Iber Lepenc", në mënyrë dhe kushte të caktuara me ligj dhe rregulla të aprovuara, janë të obliguar, që me mjete teknike dhe pajisje tjera të marrin pjesë në fikjen e zjarrit dhe shpëtimin e njerëzve dhe të pasurisë të rrezikuara nga zjarri.

## II. MASAT MBROJTËSE NGA ZJARRI

### Neni 4

- (1) Organizatat projektuese, projektantët, suinvestitorët dhe prodhuesit e pajisjes, si dhe kryesit e punëve të objektit, janë të detyruar me rastin e projektimit, prodhimit të pajisjes, ndërtimit të objekteve, hapësirave, instalimeve dhe stabilimenteve të përdorin masat dhe normat mbrojtëse nga zjarri të parapara me ligj dhe me dispozita të aprovuara në bazë të ligjit dhe masat e aprovuara me rregullore sipas dispozitave teknike.
- (2) Organizatat projektuese dhe projektantët janë të obliguar kur punojnë për objektin, që masat e mbrojtjes nga zjarri të parapara me dokumentacionin teknik të paraqiten në mënyrë të tillë, që në bazë të dhënave grafike, llogarive dhe sqarimeve teknike mund të vlerësohet sistemi i pranuar i mbrojtjes nga zjarri, funksionaliteti dhe suksesi i tij.
- (3) Në sqarimin teknik duhet të cekën dispozitat gjegjësisht rregullat e parapara teknike në të cilat bazohet sistemi i paraparë i mbrojtjes nga zjarri.
- (4) Me rastin e projektimit dhe ndërtimit të objektit në të cilën punojnë dhe qëndrojnë punëtorët duhet siguruar kushtet të cilat i mundësojnë, në rast nevoje, mundësin që shpejtë dhe pa pengesa të dalin nga objektet e tyre.
- (5) Çdo dokument teknik (projekt) duhet të ketë të siguruar vërtetimin e organit kompetent të organit Komunal, Inspektionit të mbrojtjes nga zjarri dhe dokumentacionit teknik me dispozitat e parapara ose me rregullore të praktikës teknike, të aprovuara masat mbrojtëse nga zjarri. Pa këto vërtetime organi administrativ kompetent për punë të ndërtimit nuk mund të jep lejen e ndërtimit për objekt.

*AB*

## Neni 5

- (1) Leja për përdorimin e objektit të ndërtuar, të rekonstruktuar ose të adaptuar e objektit mund të jepet kur vërtetohet se janë zbatuar masat mbrojtëse nga zjarri të parapara në dokumentacionin teknik të cilin e konstaton komisioni për kontrollimin teknik të objektit, e në të cilin merr pjesë medoemos edhe përfaqësuesi i organit kompetent, Inspekcioni i mbrojtjes nga zjarri cili e vlerëson se a janë zbatuar masat e mbrojtjes nga zjarri të parapara në dokumentacionin teknik.
- (2) Nëse me rastin e kontrollimit teknik të objektit vërtetohet se nuk janë zbatuar masat mbrojtëse nga zjarri të parapara me dokumentin teknik, nuk do të ipet leja për përdorimin e objektit gjersa të zbatohen masat e parapara.

## Neni 6

Bartësit e së drejtës së shfrytëzimit, bartësit e të drejtës së disponimit, pronarët dhe shfrytëzuesit e objektit dhe lokaleve të caktuara në objekte janë të obliguara të mbajnë në gjendje të rregullt lokalet, vendet e ngrohjes që mund të shkaktojnë zjarr. Objektet e tilla janë të detyruara që të pajisen dhe të kujdesen rreth rregullsisë së mjeteve për shuarjen e zjarrit.

## Neni 7

Mbrojtja nga zjarri në objekte zbatohet me qëllim të pengimit të shkaktimit të zjarrit duke zbatuar veprimet e rregullta të punës dhe veprimet, i cili e pamundëson shpërthimin e zjarrit dhe me detyrë të intervenimit të shpejtë dhe efikas në rast të paraqitjes së zjarrit. Zjarri i shkaktuar duhet të vihet nën kontroll dhe të pengohet zgjerimi i tij.

## Neni 8

Çdo punëtorë duhet të jetë i njoftuar me të gjitha masat preventive që kanë të bëjnë me vendin e tij në punë, objektin e tij dhe duhet të dijë të gjitha masat themelore preventive dhe të veprimit nga aspekti i mënyrës së përdorimit të aparateve për shuarjen e zjarrit me mjete që gjenden në objekt.

## Neni 9

Të gjithë punëtorët-udhëheqësit e drejtpërdrejtë dhe punëtorët tjerë të ndërmarrjes duhet të aftësohen dhe të dinë të ndërmarrin masa të duhura mbrojtëse për pengimin dhe shuarjen e zjarrit, si dhe janë të obliguar të marrin masa të mbrojtjes kundër zjarrit.

*AS*

### Neni 10

Në objekt duhet te sigurohet numri i duhur i mjeteve për fikjen e zjarrit.

### Neni 11

Të gjithë punëtorët duhet të jenë të aftë nga lëmia e mbrojtjes nga zjarri për shuarjen e zjarrit. Të gjithë punëtorët e shërbimit të sigurimit fizik duhet ti plotësojnë kushtet e parapara nga dispozitat e ruajtjes dhe sigurisë së pasurisë.

### Neni 12

Çdo punëtor duhet të përvetësoj dijëni dhe shkathtësi në përdorimin e aparateve për shuarjen e zjarrit fillestar.

### Neni 13

- (1) Punëdhënësi i ndërmarrjes është i obliguar për aftësimin e punëtorëve, mësimin dhe trajnimin e tyre të paraparë me program, me të cilin zbatohet aftësimi.
- (2) Në bazë të Ligjit për Mbrojtjen nga Zjarri dhe me këtë rregullore, parashihen, posaçërisht:
  1. Masat mbrojtëse nga zjarri me të cilat largohet dhe eliminohet rreziku nga zjarri dhe
  2. Mënyra e dhënies së lejes për kryerjen e punëve të saldimit, prerjes, lëmimit dhe punëve tjera me flakë në vende të përkohshme

### Neni 14

- (2) Punët me flakë, qark elektrik, saldim, gdhendje me autogjen, lëmimi, nxemja, pastrimi me brushë, kalitja etj., duhet patjetër të kryhen në vështrim të dispozitave të dekretit mbi masat e mbrojtjes nga zjarri me rastin e kryerjes së saldimit dhe lëmimit.
- (2) Punët paraprake dhe përgatitore bëhen me qëllim që të përmbushen kërkesat në bazë të:
  1. kërkesës për dhënien e lejes për saldim në bazë të formularit dhe
  2. pas marrjes së lejes për punë vërtetimin e siguruar nga përgjegjësit, gjegjësisht kryesit e punës dhe udhëheqësit e objektit.
- (2) Saldimin mund ta bëjnë vetëm punëtorët që i plotësojnë kushtet dhe aftësitë profesionale për përdorimin e pajisjes për saldim.

AS.

### Neni 15

- (1) Automjetet nuk duhet të parkohen në afërsi të objektit dhe në afërsi të vendeve të rrezikshme.
- (2) Në rast zjarri në instalimet elektrike të automjeteve, duhet çkyqur lidhjen e baterive dhe duhet me iu qasë menjëherë fikjes së zjarrit të automjetit me aparate për shuarjen e zjarrit, si dhe të largohen automjetet për rreth që janë të rrezikuara nga zjarri. Sipas nevojës duhet me lajmëruar njësitë profesionale të zjarrfikësve.

## III. ORGANIZIMI I MBROJTJES NGA ZJARRI

### Neni 16

- (1) Me qëllim të zbatimit të masave mbrojtëse nga zjarri, përcaktohet edhe mënyra e organizimit të mbrojtjes nga zjarri.

### Neni 17

- (1) Të gjithë punëtorët, përveç që konsiderohen si punëtorë në punë dhe detyra profesionale, janë edhe zjarrfikës dhe kanë këto detyra:
  1. Punëtori përgjegjës kontrollon objektin, lokalet, stabilimentet e sidomos ato vende të ndjeshme ku mund të jetë rreziku nga zjarri. Për shkaktarët potencial menjëherë të ndërmerr masa, së pari të lajmërojë udhëheqësin e ndërrimit, kryepunëtorin por njëkohësisht edhe vet duhet të ndërmerr masa për pengimin e shfaqjes së zjarrit;
  2. Të studioj dhe të njihet me të gjitha masat mbrojtëse në objekt në bazë të kësaj rregulloreje dhe me rregullat tjera.
  3. Të punoj në ngritjen profesionale nga lëmia e mbrojtjes nga zjarri dhe është i obliguar të ndjekë me rregull të gjitha seminarët, ushtrimet dhe vetvetiu të plotësoj dijeninë e vetë sipas detyrave që i jepen nga eprorët e vet.
- (3) Me rastin e pranimit të detyrës duhet t'i nënshtrohet kontrollit të aftësive psiko-fizike nga institucioni kompetent i mjekësisë së punës.

### Neni 18

- (1) Të drejtat dhe obligimet e punëtorëve dhe përgjegjësitë për mos zbatimin e masave të parapara të mbrojtjes nga zjarri.

AS.

(2) Të gjithë punëtorët e punësuar në ndërmarrje janë bartës themelor të punëve dhe detyrave të mbrojtjes nga zjarri, kanë të drejt dhe obligim që drejtpërdrejt të marrin pjesë në organizimin, zbatimin dhe përparimin e punëve dhe detyrave, gjegjësisht të masave të posaçme dhe të përgjithshme të mbrojtjes së njerëzve dhe pasurisë në harmoni me ligjin, me këtë rregullore dhe akte tjera e posaçërisht:

1. Të organizoj mbrojtjen e të gjitha vlerave që disponon për të siguruar sigurimin e plotë personal, pasurisë, të njerëzve dhe shoqërisë;
2. Të aftësohet e t'i nënshtrohet verifikimit të dijenisë për ndërmarrjen e drejtpërdrejt të mbrojtjes kundër zjarrit, të eliminoj shkaqet dhe dukuritë e rrezikimit dhe pasojat nga rreziku;
3. Që gjatë punës dhe pas mbarimit të orarit të punës, të përcjell dhe kontrollon punën, funksionimin dhe rregullsinë e makinave, stabilimenteve, instalimeve dhe mjeteve tjera në afërsi dhe për rreth ambientit.
4. Për çdo prishje të lajmëroj përgjegjësit me qëllim të eliminimit të defektit i cili mund të rrezikoj sigurimin e njerëzve dhe të pasurisë.
5. Të shfrytëzoj mjetet personale mbrojtëse dhe pajisjen në mënyrë që është e paraparë nga ana e prodhuesit sipas akteve të përgjithshme.
6. Drejtpërdrejt të merr pjesë në shuarjen e zjarrit dhe nëse është e mundur, pa rrezikuar vetëvetën dhe personat tjerë, të lajmëroj:
  - Njësinë e zjarrfikësve në telefon ...93, ose 038/548-005 dhe -038-543-281
  - Stacionin më të afërt të policisë në telefon...92
  - Ndihmën e shpejtë në telefon... 94

#### **Neni 19**

#### **Përgjegjësitë e punëtorëve për shkak të mosrespektimit të masave të parapara dhe të urdhëruara**

Punëtorët janë të obliguar që gjat kryerjes së detyrave të punës, t'i respektojnë masat e mbrojtjes nga zjarri, të parapara me ligj dhe akte tjera, me këtë rregullore dhe të urdhërojnë shërbimin kompetent për zbatimin e masave preventive dhe masave të urdhëruara nga organi kompetent.

#### **Neni 20**

Mosrespektimi i masave të mbrojtjes nga zjarri të cekura në nenin e mëparshëm paraqet shkelje të rëndë të detyrave të punës.

#### **Neni 21**

Këto dispozita të Rregullores janë obligative dhe zbatohen nga të gjithë punëtorët që kanë themeluar marrdhënjen e punës, si ata në kohë të pacaktuar, ashtu edhe ata në kohë të caktuar.



#### Neni 22

#### **Organizimi i vëzhgimit, lajmërimit alarmimit për rreziqet nga zjarri**

Organizimi dhe zbatimi i vëzhgimit, lajmërimit dhe alarmimit nga rreziku i zjarrit është i obliguar për të gjithë punëtorët, por përgjegjës kryesor është kryepunëtori, udhëheqësi drejtpërdrejt dhe udhëheqësi i shërbimit të sigurimit

#### Neni 23

#### **Organizimi dhe mënyra e kryerjes së kontrollit të brendshëm dhe detyrat e punëtorëve që kryejnë këtë kontroll në objekt**

- (1) Organizimi dhe mënyra e kryerjes së kontrollit të brendshëm në objekte, realizohet nga udhëheqësit drejtpërdrejt, udhëheqësit të ndërrimit etj., përmes kontrollit vizual në:
  1. aparatet për shuarjen e zjarrit;
  2. hidrante për fikjen e zjarrit;
  3. kutijat, arkat shpërndarëse etj.
- (2) Punëtori që kryen detyrën e referentit të mbrojtjes nga zjarri dhe mbrojtjes në punë është i detyruar së paku dy here në vit që të bëjë kontrollin detal të masave mbrojtëse, për çdo 6 muaj të kontrolloj rregullsinë e hidrantëve, aparateve për fikjen e zjarrit nga servisi i autorizuar, si dhe në çdo të dytin vit të bëjë kontrollimin e matjes së përtokëzuesve dhe rrufepritësve.

#### Neni 24

Sasitë dhe vendvendosja e aparateve, pajisjeve dhe mjeteve për shuarjen e zjarrit caktohen sipas dispozitave të Rregullores mbi ndërtimin e objektit.

#### Neni 25

#### **Kontrollimi, sevisimi dhe mirëmbajtja e aparateve mjeteve dhe pajisjes për shuarjen e zjarrit**

- (1) Për shuarjen e zjarrit në mënyrë efikase dhe intervenim efikas me aparate dhe pajisje është e domosdoshme të plotësohen dy kushte:
  1. Që aparatet për shuarjen e zjarrit të jenë gjithmonë në gjendje të rregullt dhe
  2. Të gjithë punëtorët të duhet t'i dinë veprimet sipas rregullave dhe të jenë të sigurt në përdorimin e aparateve dhe pajisjen për shuarjen e zjarrit.
- (2) Vendosja dhe mirëmbajtja është element me rëndësi që në masë të madhe zgjatë qëndrueshmërinë e rregullsinë e aparateve për fikjen e zjarrit. Aparatet duhet vendosur në vendet e mbrojtura nga ndikimet atmosferike (shiu, dielli, ndyrësit etj.).



- (3) Kontrollimi dhe servisimi i aparateve për fikjen e zjarrit nënkupton kontrollimin vizual i cili përbëhet prej kontrollimit të aparatit, të cilin e kryejnë punëtorët e drejtpërdrejt, me që rast konstatohet se:
1. a janë aparatet e vendosura në vende të mbrojtura nga shiu dhe dielli,
  2. a është i mundshëm ofrimi pa pengesa,
  3. a janë në aparate të vendosura pllombat dhe siguresat,
  4. a gjendet në çdo aparat kartela kontrolluese e vërtetuar nga personi
  5. zyrtar dhe i autorizuar.

(3) Këtë kontrollim në objekt është i obliguar për çdo ditë ta kryen punëtori përgjegjës për mbrojtjen kundër zjarrit dhe eprori i drejtpërdrejt. Servisimin e aparateve duhet besuar servisit të autorizuar.

1. në aparatet e grupit "P" (aparate me pluhur) përfshihen këto punë:
  - Hapja e aparatit, shkundja dhe përzierja e pluhurit,
  - Largimi, kontrolli dhe matja e enës me CO<sub>2</sub>,
  - Kontrollimi i ventilit, ventilin sigures, lidhjeve të zorrëve të gomës dhe zorrës shpërndarëse,
  - Eliminimi i prishjeve të vogla dhe zëvendësimi i tyre me pjesë të reja origjinale,
  - Mbushja me pluhur, mbyllja e aparatit, pllombimi dhe shënimi i kontrollit me kartelën kontrolluese (data dhe nënshkrimi i vërtetuar me vule).
2. në aparatet e grupit CO<sub>2</sub>:
  - Kontrollimi i matjes me peshojë i aparateve dhe përcaktimi i përmbajtjes-sasisë të shprehur në kilogram të CO<sub>2</sub> në aparat, ndërsa veprimet tjera janë identike me veprimet në aparate me pluhur

#### **Neni 26** **Përgatitja profesionale e punëtorëve**

Punët dhe detyrat profesionale -teknike mund t'i kryen çdo person që përveç kushteve të përgjithshme për themelimin e marrdhënjes së punës i plotëson edhe këto kushte:

- që të ka përgatitjen profesionale të punëtorit të kualifikuar,
- që të jetë i aftë nga aspekti psikik dhe fizik për të kryer dhe detyrat e mbrojtjes
- kundër zjarrit, shpëtimit të njerëzve dhe të pasurisë,
- mos të jetë i dënuar.

#### **Neni 27**

Çdo punëtorë është i obliguar që të merre pjesë në mësimin e organizuar teorik dhe praktik që organizohet në kuadër të ndërmarrjes me qëllim të njoftimit me

*B.*

rreziqe dhe masa kundër zjarrit, përdorimin e pajisjes dhe mjeteve për fikjen e zjarrit.

#### IV. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

##### Neni 28

Në objekt duhet të gjendet çdo herë një kopje e kësaj Rregulloreje, të cilën duhet ta shfrytëzon punëtorët dhe ta kenë në disponim për të dëshmuar se objekti posedon këtë akt normativ.

##### Neni 29

- (1) Punëtorët e posa pranuar para se të caktohen në vend të punës duhet të njoftohen me dispozitat e kësaj rregulloreje që kanë të bëjnë me të drejtat e punëtorit, detyrat dhe obligimet.
- (2) Për zbatimin e dispozitave të këtij neni dhe njoftimin me kohë të punëtorëve me masa mbrojtëse në vendet e tyre të punës kujdeset dhe është përgjegjës Udhëheqësi drejtpërdrejt.

##### Neni 30

Mjetet poseduese mbrojtëse, personale dhe paisja e cila gjendet në përdorim por edhe në stoke duhet të shfrytëzohen komfor dispozitave të kësaj Rregulloreje.

##### Neni 31 Hyrja ne fuqi

Kjo Rregullore do të hyjë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryeshefi Ekzekutiv të Ndërmarrjes.

31.05.2010

**Kryeshefi Ekzekutiv**  
**Hajdar Beqa**  
  
